



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**

**Komuna e Prishtinës**  
**Opština Priština –Municipality of Prishtina**



**KONTRATË**  
**PËR**  
**SHFRYTËZIMIN E BURSËS NGA KOMUNA E PRISHTINËS**

Për përmirësimin e situatës së studentëve të Komunës së Prishtinës, për përkrahjen e aftësimin profesional dhe shkollimit të mëtutjeshëm, për ndërlidhje mes studentëve dhe organeve të pushtetit lokal, siç është Komuna, duke pasur parasysh se Komisioni, i formuar posaçërisht për ndarjen-dhënien e bursave, nr. 14-020/04-51590/20, dt. 03.03.2020, ka aprovuar kërkesën tuaj si të bazuar, duke u mbështet në nenin 14.1 të Rregullores 01 nr. 110 - 41917, dt. 29.03.2013, Për ndarjen e bursave për studentë të Komunës së Prishtinës, autoriteti kontraktues lidh këtë kontratë në mes:

Komunës së Prishtinës, të përfaqësuar nga kryetari i Komunës së Prishtinës  
Shpend Ahmeti ( në tekstin e mëtejme: dhënësi i bursës) dhe

\_\_\_\_\_ Student nga Fakulteti \_\_\_\_\_  
(Emri Mbiemri)

Adresa: \_\_\_\_\_, me letërnjoftim personal  
nr. \_\_\_\_\_ (në tekstin e mëtejme: shfrytëzues i bursës)  
nr. i telefonit: \_\_\_\_\_  
si në vijim:

**NENI 1**

Objekt i Kontratës për shfrytëzim është shfrytëzimi i bursës për student, për vitin akademik 2019/20, në shumë prej 50 Euro për një muaj.

**NENI 2**

Me nënshkrimin e kësaj Kontrate, dhënësi i bursës i'a dorëzon shfrytëzuesit të drejtën në shfrytëzimin e bursës, me qëllim të jetësimin të qëllimeve të caktuara në preambulë.

### **NENI 3**

Dhënësi i bursës do t'i dorëzojë shfrytëzuesit për shfrytëzim bursën dhe atë në shumën prej 500 Euro, për dhjetë muaj të vitit akademik.

### **NENI 4**

Dhënësi i bursës, shumat e cekura në nenin 3 të Kontratës, shfrytëzuesit do t'i paguaj përmes xhirollogarisë, të cilën shfrytëzuesi do ta prezantojë me rastin e nënshkrimit të kësaj Kontrate.

### **NENI 5**

Dhënësi i bursës, autorizon Komisionin për ndarjen – dhënien e bursës të bëjë mbikëqyrjen e realizimit të projektit për ndarjen-dhënien e bursës.

### **NENI 6**

Ndërprerja e Kontratës për shfrytëzimin e bursës, mund të bëhet nga dhënësi i bursës nëse vërtetohet keqpërdorimi i dokumenteve zyrtare.

### **NENI 7**

Konfliktet eventuale, të paraqitura në kuadër të kësaj Kontrate, të cilat nuk mund të zgjidhen me marrëveshje, siç është paraparë me nenin 6 të kësaj Kontrate, ato do t'i parashtrohen Gjykatës së kompetencës së përgjithshme në Prishtinë.

### **NENI 8**

Kjo Kontratë është përpiluar në 2 kopje, 1 kopje për dhënësin e bursës dhe 1 kopje për shfrytëzuesin e bursës.

Në Prishtinë, më dt:                     

*Shfrytëzuesi i bursës*

*Studenti*

*Për dhënësin e bursës*

*Kryetari i Komunës  
Shpend Ahmeti*